

Termet e Referencës

Njoftim për Ekspert/Kompani për të realizuar një video të shkurtër për promovimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit mbi familjen kujdestare

Organizata	Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes,
Adresa postare:	Rr. Mine Peza, P.194, Ap.18, shk.3, Tiranë Tel: +355 (0) 4 45 20 678 Website: www.acfd.org.al
Projekti	Bëhu familja ime!
Koha e angazhimit	01 shkurt – 16 shkurt 2019
Donator i projektit	Ky projekt zhvillohet në kuadër të projektit “Zhvillimi i OSHC’ve për Familjet Kujdestare në Shqipëri” i implementuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri dhe TLAS i financuar nga Bashkimi European.

Prezantimi:

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes (ACFD) është një organizatë Jo-fitimprurëse që ushtron aktivitetin e saj në gjithë territorin shqiptar që prej vitit 2017. Misioni i qendrës është të mundësojë një të ardhme më të mirë për familjet, përmes zhvillimit të programeve në fushën e shëndetit, mirëqenies dhe sigurisë së jetës, zhvillimin e aftësive për punë, sipërmarrjes familjare dhe ofrimit të shërbimeve specifike psiko-sociale dhe ligjore në të mirë dhe në interes të familjes shqiptare. Në themel të aktivitetit të Qendrës Shqiptare për Zhvillimin e Familjes qëndron besimi në potencialin e familjes dhe rolin që ajo mund të luajë në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

ACFD, do të implementoj projektin “Bëhu familja ime” në 3 Njësitë Administrative 2, 4 dhe 11 të Bashkisë së Tiranës. Ky projekt zhvillohet në kuadër të projektit “Zhvillimi i OSHC’ve për Familjet Kujdestare në Shqipëri” i implementuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri dhe TLAS i financuar nga Bashkimi European.



This project is funded by
the European Union

Projekti do të kontribuojë në rritjen e nivelit të informacionit, ndjeshmërisë dhe mobilizimit të komunitetit të synuar, strukturave lokale përgjegjëse dhe medias ndaj rëndësisë së krijimit të një mjedisi familjar përkujdesës për fëmijët pa kujdes prindëror. Gjithashtu ky projekt synon të shërbejë edhe si një praktikë dhe model pozitiv jo vetëm për NJA-të dhe strukturat e tyre, por edhe për organizatat e tjera lokale të cilat kanë në fokus punën me çështjet e familjes në përgjithësi. Ky projekt është një fillim i vogël për një proces të gjatë drejt zhvillimit të një praktike pozitive për shërbimin e kujdestarisë nga ACFD.

Qëllimi dhe Objektivat kryesore të projektit janë:

Ky projekt synon informimin, ndërgjegjësimin dhe rritjen e ndjeshmërisë dhe interesit të komunitetit për t'u bërë familje kujdestare, si dhe ndërgjegjësimin e institucioneve përgjegjëse vendore për rolin e tyre në realizimin me efikasitet të këtij shërbimi.

Objektivat specifikë:

1. Të rrisë informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për dobinë e familjeve kujdestare dhe të krijojë një model pozitiv dhe praktik të përfshirjes së komunitetit në këtë shërbim;
2. Të ndërgjegjësojë dhe informojë strukturat përgjegjëse vendore për mënyrën e menaxhimit të shërbimit të kujdestarisë duke u fokusuar sidomos në informimin e tyre për detyrimet ligjore lidhur me identifikimin dhe futjen në skemë të familjeve potenciale për familje kujdestare;
3. Të kontribuojë në ndërtimin e mekanizmave të bashkëpunimit të komunitetit me strukturat përgjegjëse lokale për familjet kujdestare dhe median.

Në kuadër të implementimit të këtij projekti Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes kërkon të kontraktojë një ekspert apo kompani, të aftë për të demonstruar aftësi humane, etike dhe teknike dhe për të realizuar një video promovuese dhe ndërgjegjësuese për projektin e mësipërm.

Qëllimi i shërbimit:

ACFD përmes realizimit të kësaj video-promovuese synon të ndikojë në rritjen e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimit të komunitetit më të gjerë lidhur me rëndësinë e familjes kujdestare dhe nevojën e mbrojtjes së integritetit dhe cilësisë së jetës së fëmijëve pa kujdes prindëror.

Në thelb të video-mesazhit do të jetë përcjellja e idesë mbi rëndësinë se fëmijët pa familje kanë nevojë për dashuri, vëmendje, dhe model pozitiv përkujdesjeje nga i cili ata të zhvillojnë një bazë të sigurt mbi të cilën ndërtohen të gjitha marrëdhëniet.

Metodologjia

Eksperti/agjensia do të rekrutohet për të punuar ngushtë me stafin e projektit për të zhvilluar një video siç është përshkruar më sipër. Video do të tregojë praktika të ndodhura që kanë rezultuar mjaft pozitive si dhe benefitet e largimit të një fëmije të institucionalizuar dhe akomodimin në një familje kujdestare. Produkti do të përdoret si mjet promovimi dhe ndërgjegjësimi për komunitetin e gjerë, si dhe për strukturat shtetërore përgjegjëse.

Individi ose agjensia duhet të punojë ngushtësisht me ACFD-në në përgatitjen e skemës dhe prodhimit përfundimtar të mbuluar nga ky TOR. Para fillimit të zhvillimit të dokumentacionit të videos të praktikave më të mira të rasteve, do të mbahet një takim fillestar ndërmjet individit/agjencisë dhe ACFD-së dhe më pas të dy palët do të takohen në baza një javore për të vlerësuar progresin dhe sfidat e procesit. Në fund të konsultimit, do të organizohet një takim mes personave që do të përfshihen në video, ekspertit dhe stafit të ACFD-së, në mënyrë që ekspertët të realizojnë filmimet e nevojshme.

Detyrat që pritet të realizohen nga Eksperti/Agjensia:

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Menaxheres të Projektit dhe ekspertit të fushës pranë qendrës individët/agjencia pritet të:

- Përcaktojë një plan kohor që tregon kohën e nevojshme për përgatitjen, xhirimin, redaktimin dhe finalizimin e videos;
- Kryerja e xhirimeve (versionet e regjistrimit të gjata dhe të shkurtra) të aktorëve të përfshirë të projektit;
- Zhvillimi i procedurave të përshtatshme për redaktimin dhe finalizimin e pamjeve të përgjithshme në versionin përfundimtar të titruar.

Përgjegjësitë e ACFD-së

- Të sigurojë të gjitha materialet e kërkuara në kohën e duhur;
- Të identifikojë pjesëmarrësit për videon dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tyre;
- Lehtësimi i bërjes së videos në zonat ku implementohet projekti,
- Të mbikëqyrë ofruesin e shërbimeve duke menaxhuar kontratën e konsulencës;
- Monitoron respektimin e afateve të përcaktuara;
- Lehtësimi për dhënien e informacionit të kërkuar;
- Ofrimi i udhëzimeve në të gjitha fazat e ekzekutimit, miratimi i të gjitha rezultateve dhe lehtësimi i hedhjes së videos në faqen e projektit dhe ndërhyrjet.

Vendi i konsulencës: Tiranë

Kohëzgjatja e konsulencës: 01 shkurt – 16 shkurt 2019

Produkti: Kompania pritët të dorëzojë tek Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes një video me kohëzgjatje 1'30''- 2'' jo më vonë se data 16 shkurt 2019.

Rezultatet kryesore të detyrës do të jenë: • Hartimi i draftit të historisë për komentet dhe kontributet e ekipit të projektit – 6 shkurt 2019 • Drafti i parë i videos, • Dorëzimi i draftit përfundimtar të videos • Dorëzimi përfundimtar i videos deri më 16 shkurt 2019.

SPECIFIKIMET E TJERA: Video do të jetë në gjuhën shqipe dhe me titra në gjuhën angleze dhe paraqitja e saj duhet të jetë në përputhje me Udhëzimet e Bashkimit Evropian për vizibilitetin dhe duhet të ketë logot e donatorëve dhe ACFD-së. Kohëzgjatja duhet të jetë 1'30''- 2''. Video duhet të dorëzohet në HD me CD (2 kopje).

Kualifikimet, Përvoja e kërkuar: • Eksperiencë e provuar në përgatitjen e Mesazheve/spoteve me natyrë Sociale në Shqipëri në mënyrë të ndjeshme dhe etike (Duhet të sigurohen linket e videos /



spoteve / rasteve / dokumentarëve); • Aftësi e provuar për të përmbushur afatet dhe për të punuar nën presion; • Fleksibiliteti në përgjigjen ndaj nevojave të agjencisë kontraktuese. Kualifikimi ose eksperiencia që kërkohet • Preferohen aplikime nga ekspert/kompani të cilët e ushtrojnë aktivitetin në qytetin e Tiranës.

Paraqitja e aplikimit: Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin

- Letër interesi (për ekspert/e)
- CV-në e tyre profesionale PDF ose MS Word
- Ofertën financiare
- Kopje të QKB dhe NIPT (për kompanitë/agjencitë)

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dërgohet në adresën e emailit: info@acfd.org.al ose mund të dërgohen me postë në adresën: Rr. Mine Peza, P.194, Ap.18, Shk.3, deri në ditën e mbylljes së thirrjes, **27 janar 2019**.

Ju lutemi sigurohuni që subjekti i aplikimit të përfshijë titullin e thirrjes për të cilën aplikohet. Aty ku është e mundur, në aplikimet e tyre kandidatët duhet të paraqesin dëshmi të një pune të mëparshme siç përcaktohet në këto Terma Reference.

Përzgjedhja e individit do të bazohet në: • Sa mirë aplikimi plotëson kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës. • Përvojë relevante; Oferta financiare e propozuar më e ulët;

Vetëm kandidati/agjencia i/e përzgjedhur do të njoftohet.



This project is funded by
the European Union